

Përgjegjës/ Sektori i Analizës së Burimeve të Hapura, Drejtoria e Analizës së Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik " i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar, ligjit nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 12.12.2022 "Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK", i ndryshuar, urdhrin të Kryeministrit nr. 32, datë 16.03.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Përgjegjës/ Sektori i Analizës së Burimeve të Hapura, Drejtoria e Analizës së Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Bashkëpunon me ekipin për realizimin e programit të brendshëm të punës;
- Jep zgjidhje konkrete për problemet që ndeshen gjatë kryerjes së detyrës;
- Jep kontribut në përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, për sa i përket fushës së veprimtimit të Autoritetit;
- Zbaton aktet ligjore e nënligjore që dalin në funksion të objektit të veprimtarisë së Autoritetit;
- Siguron ndihmë dhe mbështetje metodike për operatorët përgjegjës në fushën e sigurisë kibernetike;
- Bashkëpunon ngushtë me ekipet e tjera të institucionit, për të krijuar një raport të qartë të problemeve të sigurisë në infrastrukturën, për të cilat janë realizuar testimet;
- Kryen me përpikmëri detyrat e dhëna nga eprori direkt dhe në përputhje me procedurat dhe rregulloret e institucionit;
- Kryen analiza të thelluara të kërcënimeve kibernetike, duke përfshirë *malware*, *phishing* dhe aktivitete të tjera me qëllim të keq;
- Analizon raporte dhe *loge*, të marra nga sistemet e ndryshme për kryerjen e analizave, në raste incidentesh;
- Bashkëpunon ngushtë me ekipet e tjera të institucionit, për të krijuar një raport të qartë të problemeve të sigurisë në infrastrukturën, për të cilat janë realizuar testimet;

- Kryen me përpikëri detyrat e dhëna nga drejtuesi dhe në përputhje me procedurat dhe rregulloret e institucionit.

KËRKESAT E POSAÇME

Arsimi: Niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, në Teknologji Informacioni/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Shkenca Kompjuterike/ Informatikë Ekonomike.

Përvoja: Të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune në profesion nga të cilat jo më pak se 2 vjet përvojë në sektorët që trajtojnë dhe menaxhojnë incidentet kibernetike.

Atësitë: Njohuri shumë të mira në fushën e sigurisë kibernetike, e lidhur kjo me detyrimet e Autoritetit për realizimin e politikave dhe programeve lidhur me këtë fushë. Aftësi për të realizuar objektivat teknike, për të simuluar sulmet dhe për të analizuar informacionet (*loget*), risqet dhe ndjekur masat e kundërmasat për mbrojtjen; aftësi për të komunikuar në grup e për të përballuar situata kritike, si dhe shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi, prezantimi dhe punë në grup.

Të njohë mirë gjuhën angleze.

Të disponojë certifikime në fushën e sigurisë kibernetike lidhur me proceset: Digital Forensics, Ethical Hacking, Sql Injection Attacks, Mitre Attack, etj.

Përbën avantazh pajisja me certifikime profesionale: Certifikatë në administrim rrjetash, menaxhim sistemesh: IT security (CompTia Security+), Malware Analysis, Digital Forensics, pjesëmarrje në trajnime për rritjen e kapaciteteve mbi mbrojtjen ndaj sulmeve Ransomware, pjesëmarrje në Cyber Ranges dhe Cyber Drills. Njohuri në vlerësimet e rrezikut të sigurisë së informacionit. Njohuri të mira në gjuhët kompjuterike (programim). Njohuri në Penetration Testing: Kali linux, Social Engineering, etj.

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Ligji nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, e lidhur kjo me detyrimet e autoritetit për realizimin e politikave dhe programeve lidhur me këtë fushë;
- Njohuri në vlerësimet e rrezikut të sigurisë së informacionit;
- Njohuri në gjuhët kompjuterike (programim);
- Njohur rreth *Dark Web Investigation, Ethical Hacking, Mitre attack Fundamentals*.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (III-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 20.09.2023, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell s’kualifikim të kandidatit.